

Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 19.3.2020

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu I, Gërma A, Pika 1	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) , jo më vonë se 10 ditë pune nga krijimi i vendit të lirë për drejtor, ka njoftuar zyrtarisht Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) për vendin e lirë të punës.		
Kreu I, Gërma A, Pika 2	DRAP-i ka shpallur vendin e lirë të punës për drejtor, jo më vonë se 5 ditë pune nga njoftimi i ZVAP-it.		
Kreu I, Gërma A, Pika 3	DRAP-i ka shpallur vendin e lirë për drejtor të institucionit publik të arsimit parauniversitar në faqen elektronike zyrtare të DRAP-it dhe ZVAP-it dhe në këndin e njoftimeve të ZVAP-it. Institucioni publik i arsimit parauniversitar përkatës ka shpallur vendin e lirë për drejtor në këndin e njoftimeve të tij.		
Kreu I, Gërma A, Pika 4. Gërma a	Shpallja e vendit të lirë të punës përmban kushtet, që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP-it.		
Kreu I, Gërma A, Pika 4, Gërma b	Shpallja e vendit të lirë të punës përmban dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit të tij.		
Kreu I, Gërma A, Pika 4, Gërma c	Shpallja e vendit të lirë të punës përmban datën e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit.		
Kreu I, Gërma A, Pika 4, Gërma d	Shpallja e vendit të lirë të punës përmban afatin e plotësimit të dokumentacionit, pas verifikimit paraprak të tij.		
Kreu I, Gërma A, Pika 4, Gërma e	Shpallja e vendit të lirë të punës përmban fushat e njohurive dhe aftësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar.		
Kreu I, Gërma A, Pika 4, Gërma f	Shpallja e vendit të lirë të punës përmban datën e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyrën e komunikimit të tyre.		
Kreu I, Gërma B, Pika 1, Gërma a	Kandidati për drejtor ka fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 8/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.		
Kreu I, Gërma B, Pika 1, Gërma b	Kandidati për drejtor ka të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”.		
Kreu I, Gërma B, Pika 1, Gërma c	Kandidati për drejtor nuk ka masa disiplinore në fuqi ndaj tij.		
Kreu I, Gërma B, Pika 1, Gërma d (e # me 7/1)	Kandidati për drejtor i IPAP-it është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe është		

	certifikuar nga kjo shkollë, në përputhje me pikën 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.		
Kreu I, Gërma B, Pika 2, Gërma a	Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi).		
Kreu I, Gërma B, Pika 2, Gërma b	Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës.		
Kreu I, Gërma B, Pika 2, Gërma c	Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban kopjen e dokumentit të identitetit (ID-së).		
Kreu I, Gërma B, Pika 2, Gërma d	Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4).		
Kreu I, Gërma B, Pika 2, Gërma e	Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban certifikatën e drejtuesit të IPAP-it, nga Shkolla e Drejtorëve.		
Kreu I, Gërma B, Pika 2, Gërma f	Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, të këtij udhëzimi).		
Kreu I, Gërma B, Pika 2, Gërma g	Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban vërtetimin nga institucioni ku ka punuar, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.		
Kreu I, Gërma B, Pika 2, Gërma h	Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP-it (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, të këtij udhëzimi.		
Kreu I, Gërma B, Pika 3	Drejtori aktual i IPAP-it ose zëvendësuesi i tij ka vënë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të: a) planit afatmesëm të shkollës; b) planit vjetor të shkollës të vitit paraardhës; c) raportit vjetor të shkollës të vitit paraardhës.		
Kreu I, Gërma B, Pika 4	Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2, të shkronjës B, të këtij udhëzimi, është dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP, jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për drejtor të IPAP-it në faqen elektronike zyrtare të DRAP-it.		
Kreu I, Gërma C, Pika 1	ZVAP-i ka ngritur komisionin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP.		
Kreu I, Gërma C, Pika 2	Komisioni përbëhet nga: a) kryetari i bordit të IPAP-it; b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP-it;		

	<p>c) dy mësues të IPAP-it, të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;</p> <p>d) një përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes vendore.</p>		
Kreu I, Gërma C, Pika 3	Këshilli i mësuesve të IPAP-it ka zgjedhur si anëtarë të komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash.		
Kreu I, Gërma C, Pika 4	Komisioni është drejtuar nga mësuesi anëtar i tij, me përvojën më të gjatë në IPAP.		
Kreu I, Gërma C, Pika 5	Anëtarët e komisionit nuk kanë qenë në konflikt interesi me aplikantin, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit. Anëtarët e komisionit, në mbledhjen e parë të komisionit, kanë plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 3/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.		
Kreu I, Gërma C, Pika 6	ZVAP-i ka njoftuar zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP-it/DRAP-it.		
Kreu I, Gërma C, Pika 7	Në mbledhjet e Komisionit janë ftuar të marrin pjesë, pa të drejtë vote, edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, që kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse të arsimit.		
Kreu I, Gërma C, Pika 8	Komisioni është mbledhur në mjediset e IPAP-it ose ZVAP-it, jo më vonë se 3 ditë pune pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për drejtor të IPAP-it dhe kur kanë qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij.		
Kreu I, Gërma C, Pika 9	Anëtari i Komisionit që ka munguar, ose që ka qenë në konflikt interesi me aplikantin, është zëvendësuar. Zëvendësimi është kryer brenda një dite pune nga titullari i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, për anëtarin e zgjedhur prej tij; bordi i IPAP-it, këshilli i prindërve të IPAP-it ose këshilli i mësuesve, për anëtarët e zgjedhur prej tyre.		
Kreu I, Gërma C, Pika 10, Gërma a	Komisioni ka shqyrtuar paraprakisht dokumentacionin e paraqitur në dosjen e aplikimit, brenda dy ditëve pune, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.		
Kreu I, Gërma C, Pika 10, Gërma b	Komisioni ka njoftuar me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion, për mangësitë e konstatuara, duke caktuar si afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune.		
Kreu I, Gërma C, Pika 10, Gërma c	Komisioni, pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, ka listuar aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, për t'u vlerësuar prej tij.		
Kreu I, Gërma C, Pika 10, Gërma d	Komisioni ka vlerësuar me pikë aplikantët e pranuar si kandidatë për drejtor të IPAP-it, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.		
Kreu I, Gërma C, Pika 10, Gërma e	Komisioni ka realizuar intervistën e strukturuar me secilin kandidat, për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit.		

	Çdo anëtar i komisionit ka vlerësuar intervistën me pikë nga 1 në 10.		
Kreu I, Gërma C, Pika 10, Gërma f	Komisioni ka hartuar tabelën e pikëve dhe ka renditur kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës.		
Kreu I, Gërma C, Pika 10/g	Komisioni, brenda tri ditëve pune, ka shpallur në këndin e njoftimeve të IPAP-it, tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.		
Kreu I, Gërma C, Pika 11	Kandidatëve u është dhënë e drejta për të paraqitur ankim me shkrim para komisionit, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve. Komisioni ka shqyrtuar ankesat brenda 1 dite pune.		
Kreu I, Gërma C, Pika 12	Kryetari i komisionit i ka dorëzuar drejtorit të ZVAP-it, dosjet e aplikimit dhe vlerësimin me pikë, për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e shkollës.		
Kreu I, Gërma D, Pika 1	Spektori i shërbimeve në ZVAP ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP-it, ka shqyrtuar dokumentacionin e komisionit dhe e ka kthyer atë, vetëm nëse ka konstatuar parregullsi të natyrës teknike.		
Kreu I, Gërma D, Pika 2	Drejtori i ZVAP-it, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga komisioni, ka përcjellë dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.		
Kreu I, Gërma D, Pika 3	Drejtori i DRAP-it, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP-i, ka intervistuar dy kandidatët.		
Kreu I, Gërma D, Pika 4	Intervistat janë regjistruar nga sekretari i drejtorit të DRAP-it dhe janë arkivuar në DRAP.		
Kreu I, Gërma D, Pika 5	Drejtori i DRAP-it, brenda 3 ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët, ka shpallur vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP-it.		
Kreu I, Gërma D, Pika 8	Drejtori i DRAP-it ka bërë emërimin e drejtorit të IPAP-it dhe ia ka komunikuar vendimin zyrtarisht ZVAP-it. ZVAP-i i ka dërguar vendimin e emërimit drejtorit të sapoemëruar dhe drejtorit zëvendësues.		
Kreu I, Gërma D, Pika 9	Drejtori i IPAP-it, pas emërimit, nuk bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike.		
Kreu I, Gërma E, Pika 1	Kur drejtori i IPAP-it, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk e ka ushtruar përkohësisht detyrën e tij, drejtori i DRAP-it ka caktuar nëndrejtorin e këtij institucioni ose një mësues të IPAP-it, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit.		
Kreu I, Gërma E, Pika 2	Kur vendi i drejtorit të IPAP-it është shpallur i lirë, drejtori i DRAP-it ka caktuar nëndrejtorin e këtij institucioni ose një		

	mësues të IPAP-it, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit, deri në përfundimin e procesit të konkurrimit, sipas afateve të përcaktuara në kreun I, të këtij udhëzimi.		
Kreu I, Gërma E, Pika 3	Tejkalimi i afateve të përcaktuara në kreun I, të këtij udhëzimi është shoqëruar me masë disiplinore për drejtorin e ZVAP-it.		
Kreu I, Gërma F, Pika 1	Në rastet kur nuk janë paraqitur aplikantë ose ka vetëm një aplikant, detyrën e drejtorit të IPAP-it e kryen përkohësisht drejtori zëvendësues, sipas shkronjës E, të kreut I, të këtij udhëzimi. Vendi për drejtor është rishpallur sipas procedurës së mësipërme.		
Kreu I, Gërma F, Pika 2	Kur ka pasur më shumë se dy kandidatë me numër të njëjtë pikësh, janë veçuar dy kandidatët për drejtor që kanë marrë më shumë pikë në intervistën e strukturuar përpara komisionit.		
Kreu II, Gërma A, Gërma a	Mbarimi i marrëdhënies së punës së drejtorit të IPAP-it është bërë, kur ka dhënë dorëheqjen.		
Kreu II, Gërma A, Gërma b	Mbarimi i marrëdhënies së punës së drejtorit të IPAP-it është bërë, kur ka mbushur moshën e pensionit.		
Kreu II, Gërma A, Gërma c	Mbarimi i marrëdhënies së punës së drejtorit të IPAP-it është bërë, kur është provuar paaftësia për kryerjen e detyrave me vendim të komisionit mjeko-ligjor.		
Kreu II, Gërma A, Gërma d	Mbarimi i marrëdhënies së punës së drejtorit të IPAP-it është bërë, kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.		
Kreu II, Gërma A, Gërma e	Mbarimi i marrëdhënies së punës së drejtorit të IPAP-it është bërë, kur është marrë masa disiplinore e largimit nga puna nga drejtori i DRAP-it.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma a	Drejtori i DRAP-it ka shkarkuar drejtorin e IPAP-it, kur ka pasur vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma b	Drejtori i DRAP-it ka shkarkuar drejtorin e IPAP-it pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar, për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në menaxhimin e IPAP-it.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma c	Drejtori i DRAP-it ka shkarkuar drejtorin e një IPAP-it kur ka përsëritur shkelje, për të cilat ka qenë ende në fuqi masa e vendosur nga Komisioni i Disiplinës në DRAP “paralajmërim për largim nga puna”.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma b	Drejtori i DRAP-it e ka shkarkuar drejtorin e një IPAP-i, kur ka kryer shkelje të procedurave të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe/ose Maturës Shtetërore.		

Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma c	Drejtori i DRAP-it ka shkarkuar drejtorin e një IPAP-i, kur ka organizuar ose ka lejuar gjatë procesit mësimor, pjesëmarrjen e mësuesve ose nxënësve në veprimtari partiake, ose ka marrë pjesë në to.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma d	Drejtori i DRAP-it ka shkarkuar drejtorin e një IPAP-i kur ka konstatuar se pas emërimit, drejtori i IPAP-it bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike. Në këtë rast, drejtori i ZVAP-it i ka kërkuar zyrtarisht DRAP-it shkarkimin e drejtorit të IPAP-it nga funksioni që kryen. DRAP-i ka marrë vendimin përfundimtar jo më shumë se pesë ditë pas kërkesës së ZVAP-it.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma e	Drejtori i DRAP-it ka shkarkuar drejtorin e një IPAP-i, kur IPAP-i që ai ka drejtuar ka pasur dy vlerësime të njëpasnjëshme “dobët”, nga ZVAP-i.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma h	Drejtori i DRAP-it ka shkarkuar drejtorin e një IPAP-i, kur ai ka kryer veprimtari në kundërshtim me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri përgjegjës për arsimin parauniversitar.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma j (e shtuar me 7/2)	Drejtori i DRAP-it ka shkarkuar drejtorin e IPAP-it, kur ai nuk është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e IPAP-it ose nuk ka kaluar me sukses procesin e testimit për pajisjen me certifikatë nga Shkolla e Drejtorëve.		
Kreu II, Gërma B, Pika 2	Për rastet e parashikuara në pikën 1/a, të shkronjës B, të këtij kreu, nëse kanë filluar hetime paraprake ndaj drejtorit të IPAP-it, drejtori i DRAP-it, pas njoftimit zyrtar të drejtorit të ZVAP-it, ka marrë vendimin e pezullimit të drejtorit të IPAP-it, deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente.		
Kreu II, Gërma B, Pika 3	DRAP-i ruan në arkivin e tij, sipas përcaktimeve ligjore, vendimin e drejtorit të DRAP-it për pezullimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit të IPAP-it.		
Kreu II, Gërma B, Pika 4	Drejtori i DRAP-it ka paralajmëruar drejtorin e IPAP-it për shkarkim, kur ka provuar se ai nuk ka marrë masë për largim nga puna ndaj mësuesit, që ka kryer shkelje që parashikohen në udhëzimin për procedurat e emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në IPAP. Drejtori i DRAP-it e ka shkarkuar drejtorin e IPAP-it, kur e ka përsëritur këtë veprim më shumë se një herë.		
Kreu II, Gërma B, Pika 5	Drejtori i DRAP-it ka filluar procedurën për shkarkimin e drejtorit të IPAP-it, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative.		
Kreu II, Gërma B, Pika 6	Drejtorit të IPAP-it i është dhënë e drejta të dëgjohet nga drejtori i DRAP-it, para se të merret vendimi i shkarkimit të tij. Seanca dëgjimore e drejtorit të DRAP me drejtorin e IPAP-it është mbajtur shënim nga sekretari i drejtorit të DRAP-it dhe		

	është arkivuar.		
Kreu III, Pika 1 (e # me 7/3)	Drejtori në detyrë i IPAP-it, për vijimin e detyrës, përveç kriterëve të përcaktuara në pikat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1, të shkronjës “B” të Kreut I, të këtij udhëzimi, ka aplikuar për t’u pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor dhe certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve.		